

# Përkrahja e grave ndërmarrëse në Kosovë

Mbështetja e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë



Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH, duke vepruar në emër të Qeverisë Gjermane, dhe organizata Kosova Women for Women (KW4W) kanë punuar së bashku për të krijuar një logo të re për bizneset e grave. Qëllimi është të drejtojnë vëmendjen kah bizneset kosovare në pronësi ose në bashkëpronësi të grave, ose ndërmarrjeve ku gjysma e punonjësve të tyre janë gra. KW4W dhe GIZ Kosova bashkëpunojnë për të mbështetur bizneset e grave me mentorim, trajnime dhe mundësi rrjetëzimi. Kjo kontribuon në rritjen dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të bizneseve të drejtuara nga gratë dhe ekonominë kosovare. Pjesët në vijim do të shtjellojnë më tej bashkëpunimin midis KW4W dhe GIZ për mbështetjen e grave në Kosovë.

## Pse ka rëndësi mbështetja e bizneseve në pronësi të grave

Paragjykimi shoqëror është një nga faktorët kryesorë që dekurajojnë gratë kosovare të përfshihen në veprimtari biznesore. Ndërsa gratë përbëjnë 49,7 përqind të popullsisë në moshë pune në Kosovë, 80 përqind e grave në moshë pune nuk marrin pjesë në tregun e punës<sup>1</sup>. Pozicioni i grave ndikohet nga rolet tradicionale gjinore, normat shoqërore dhe përgjegjësitë familjare.

Pandemia COVID-19 në vitin 2020 intensifikoi ato çështje ekzistuese gjinore. Pas rasteve të para të konfirmuara të COVID-19 në Kosovë në mars 2020 dhe zbatimit të kufizimeve për shkaqe sigurie, detyrat e grave ndaj familjeve të tyre u shumëfishuan. Në të njëjtën kohë, numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici u rrit në mënyrë dramatike: Vetëm midis janarit dhe korrikut të vitit 2020, u raportuan 1186 raste. Sidoqoftë, rastet e raportuara nuk pasqyrojnë shtrirjen reale të çështjes, pasi dhuna seksuale, psikologjike dhe ekonomike shpesh nuk raportohen sa duhet. Përkundër përpjekjeve të lëvizjes feministe për të fuqizuar pozitën e grave në familje dhe në publik në Kosovë, dhuna në familje ende konsiderohet si çështje private. Ndërkohë, shteti i Kosovës nuk arrin të ofrojë politika efektive gjinore, si dhe qasje në drejtësi dhe mundësi të barabarta. Këto dështime institucionale kanë rritur nevojën për politika emancipuese dhe mbrojtëse për gratë në Kosovë dhe nxjerrin në pah nevojën për projekte me bazë gjinore<sup>2</sup>.

Gratë në Kosovë përfaqësojnë vetëm 10 përqind të ndërmarrësve ose pronarëve të bizneseve për bizneset që zakonisht janë mikro ose të vogla<sup>3</sup>. Vetëm 3 përqind e të gjitha kredive biznesore shkojnë për gratë<sup>4</sup>. Bizneset e filluara dhe të

udhëhequra nga gratë në Kosovë janë zakonisht më të vogla, që janë të përqendruara në sektorin informal dhe kanë pak të ngjarë të operojnë në sektorë me vlerë të shtuar të lartë me potencial rritjeje. Si rrjedhojë, një numër i madh i këtyre bizneseve nuk kanë aftësi dhe njohuri për të zgjeruar biznesin e tyre në një mënyrë të suksesshme dhe të qëndrueshme ose për t'u shndërruar nga një kompani jo-punëdhënëse në një punëdhënëse. Kjo është shkaktuar kryesisht nga vështirësitë që hasin gratë kosovare për të marrë kredi, për të pasur qasje në informacione, tregje potenciale dhe teknologji<sup>5</sup>. Atyre shpesh u mungojnë garancitë në formë të hipotekave, historiku kreditor dhe lidhjet<sup>6</sup>. Gratë afariste identifikojnë sfidat e tyre kryesore në kombinim me çështje financiare siç janë rregulloret e pamjaftueshme tatimore, praktikat e këqija bankare, klima përgjithësisht e dobët e investimeve në Kosovë dhe diskriminimi nga klientët<sup>7</sup>.

## Puna e Kosova-Women 4 Women

Kosova-Women 4 Women (KW4W) është organizatë vendore ndërtuar mbi themelin e hedhur nga Women for Women International (WfWI). Ajo filloi të punojë si pjesë e WfWI në Kosovë në vitin 1999. Misioni i saj është të mbështesë gratë e marginalizuara në Kosovë dhe t'i ndihmojë ato të fitojnë dhe të kursejnë para, të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien, të ndikojnë në vendimet brenda familjes dhe komunitetit dhe të japin mbështetje për rrjetëzim. Duke përdorur aftësitë, njohuritë dhe burimet, gratë do të jenë në gjendje të krijojnë ndryshime të qëndrueshme për veten e tyre, familjet e tyre dhe komunitetin.

KW4W promovon fuqizimin e grave dhe ofron një program të kombinuar social dhe ekonomik. Programet përfshijnë trajnime, aktivitete të avokimit, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe ndërgjegjësim për të drejtat e grave. Organizata gjithashtu

<sup>1</sup>Eurostat (Feb 2020). *Enlargement countries – labour market statistics*. Eurostat. Statistics Explained.

[https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement\\_countries\\_-\\_labour\\_market\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_-_labour_market_statistics)

<sup>2</sup>European Commission (2020). *Kosovo 2020 Report*. Commission Staff Working Document. European Commission, Brussels. [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf)

<sup>3</sup>Mehmeti, I., Dobranja, D., & Hashani, A. (2017). *Women in the Workforce – An Analysis of the Workforce Conditions for Women in Kosovo*. Riinvest Insitute. [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Women\\_in\\_the\\_workforce1510308291.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Women_in_the_workforce1510308291.pdf)

<sup>4</sup>USAID (2015). *Women Gain Traction in Kosovo's Business Sector*. USAID. <https://www.usaid.gov/results-data/success-stories/women-succeeding-business-kosovo>

<sup>5</sup>Mehmeti, I., Dobranja, D., Hashani, A., & Beqiri, G. (2017). *Women's Entrepreneurship – An Analysis of Doing Business in Kosovo*. Riinvest Insitute.

[https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens\\_Entrepreneurship1510307815.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2017/November/10/Womens_Entrepreneurship1510307815.pdf)

<sup>6</sup>Färnsveden U. Qosaj-Mustafa, A., & Farnsworth, N. (2014). *Kosovo Country Gender Profile*. ORGUT Consulting AB.

<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20140513160130237.pdf>

<sup>7</sup>Färnsveden U. Qosaj-Mustafa, A., & Farnsworth, N. (2014). *Kosovo Country Gender Profile*. ORGUT Consulting AB.

<https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20140513160130237.pdf>

promovon vlera kulturore dhe tradicionale përmes promovimit të punës me dorë dhe artizanatit. Gratë në zonat rurale marrin ndihmë përmes produkteve bujqësore. Mbi të gjitha, gratë inkurajohen të formojnë grupe të tilla si kooperativa ose shoqata dhe të lidhen, të krijojnë rrjete me njëra-tjetrën dhe të jenë të pavarura. Kjo iniciativë synon kohezionin social dhe qëndrueshmërinë ekonomike mes tyre.

## Promovimi i bizneseve në pronësi të grave

Bazuar në një raport të analizës të përgatitur më parë, KW4W angazhoi një kompani marketingu për të krijuar një logo të re që identifikon bizneset e grave. Fushata përfshinë një dizajn të brendit me një strategji për marrëdhënien me publikun dhe materiale të marketingut si p.sh. video incizime ose postera (p.sh., Figura 1). Qëllimi i brendit të ri është të ndihmojë në identifikimin e bizneseve dhe kompanive në pronësi dhe në bashkëpronësi të grave si dhe kompanive ku gjysma e punonjësve të tyre janë gra. Kjo kontribuon në rritjen e biznesit dhe qëndrueshmërinë e bizneseve në pronësi të grave duke mbështetur punësimin dhe pavarësinë ekonomike të grave. Logoja e re fton publikun dhe klientët e mundshëm dhe partnerët e biznesit për t'i dhënë mbështetje të veçantë bizneseve të grave. Përveç kësaj, ajo synon të rrisë ndërgjegjësimin për çështjet me të cilat sot gratë përballesh në punën e tyre ditore.



Figura : Material ilustrativ i marketingut për brendin e ri të biznesit në pronësi të grave

## Fuqizimi i bizneseve në pronësi të grave

Për të kontribuar në përmirësimin e situatës së grave në Kosovë në përgjithësi, GIZ mbështet punën e KW4W në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim. Në thelbin e tij, bashkëpunimi synon të ndihmojë bizneset në pronësi të grave në dy faza: Bizneset tanimë ekzistuese kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve për operacione funksionale biznesore. Bizneset në një fazë të hershme të zhvillimit ose gratë që kanë ide inovative për të

filluar një biznes të ri dhe që kanë nevojë për mbështetje për ta filluar ndërmarrjen e tyre. Një fokus tjetër i bashkëpunimit është bashkëpunimi dhe koordinimi midis bizneseve në pronësi të grave dhe ndërmarrjeve të mundshme sociale në të ardhmen. Për më tepër, një pjesë e vogël e bashkëpunimit i kushtohet mbështetjes së grave rurale, duke inkurajuar organizimin e tyre si shoqata me mision ekonomik. Si dhe aktivitete të përbashkëta për të shndërruar aktivitetet e tyre ekonomike në ndërmarrje shoqërore. Për ta përmbledhur, qëllimi kryesor është që kontribuohet në rritjen ekonomike, qëndrueshmërinë e bizneseve në pronësi dhe bashkëpronësi të grave dhe mundësimin e punësimit të rreth 150 grave. Katër objektivat specifike për të arritur këtë qëllim janë:

1. Iniciativat e grave si dhe bizneset në pronësi dhe bashkëpronësi të grave kanë kapacitete për të funksionuar si biznese të qëndrueshme dhe të suksesshme që mbështesin dhe punësojnë gra të tjera.
2. Një brend i re i Biznesit në Pronësi të Grave (BPG) është iniciuar dhe promovuar për të mbështetur gratë në ekonomi.
3. Vendoset bashkëpunimi midis bizneseve në pronësi të grave, bizneseve që punësojnë kryesisht gra dhe grupeve të formalizuara të grave për mësim, koordinim dhe kohezion.
4. OJQ-ja Nisja Zhvillohu ka ndërtuar kapacitetet e saj duke u përfshirë në aktivitete përkatëse dhe duke mësuar nga aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të KW4W.

Grupet e synuara të bashkëpunimit:

1. Gratë që janë në pronësi ose bashkëpronësi të bizneseve ose bizneset ku mbi 50% e punonjësve janë gra.
2. Punonjëset e grupit të parë, të cilat do të mund të punësohen posa bizneset të fuqizohen dhe të bëhen të qëndrueshme.
3. Grupet e grave që janë të organizuara si kooperativa ose shoqata që së shpejti do të jenë biznese sociale të përfshira në aktivitete ekonomike, dhe anëtarët e tyre.
4. OJQ Nisja Zhvillohu dhe stafi i saj e cila përfiton nga aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve nga KW4W.

Përveç fushatës së brendit "Bizneset në pronësi të grave", bashkëpunimi midis KW4W dhe GIZ gjithashtu ofron aktivitete të mëtejshme për grupin e synuar të përshkruar:

- Raporti i analizës për bizneset në pronësi dhe bashkëpronësi të grave;
- 25 biznese përfituese morën pjesë në seanca trajnimi dhe këshillimi si dhe trajnime të personalizuara bazuar në nevojat e tyre;
- 49 grante me rreth 133,000 € për idetë lidhur me bizneset e grave me fokus në ide inovative, promovim të punësimit, zgjerim të produkteve dhe shërbimeve, promovim dhe marketing si dhe mikro infrastrukturë;
- Ngjarjet Biznes për Biznes (B2B) me biznese në pronësi të grave, si dhe akterë të tjerë të tregut në Kosovë dhe rajon;
- Mbështetje për pjesëmarrjen në panairt lokale dhe rajonale me produktet e prodhuara nga gratë.

---

Publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Zyrat e regjistruara në Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Krijimi i punësimit përmes promovimit të eksportit  
Zyra e GIZ Kosovë  
Rruga Gazmend Zajmi 80

10 000 Prishtinë, Kosovë.  
Tel. +381 (0) 38 233 002 507  
Fax +381 (0) 38 233 002 530  
giz-kosovo-buero@giz.de

prej

Mars 2021

Dizajni

MLE Group sh.p.k., Prishtinë

Dzajni i kopertinës

Engjell Sokoli

Teksti

Lendita Kastrati

GIZ është përgjegjëse për përmbajtjen e këtij publikimi.

Në emër të

Ministrisë Federale për Bashkëpunim  
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)